

NJOFTIM MBI ZGJATJEN E AFATIT PËR DORËZIM TË OFERTAVE

*Procedurë e hapur
Shërbim*

Në përputhje me nenin 25, të Rregullës së Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

I. BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, BQK,
Adresa: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë

II. Njoftim nga BQK për operatorët ekonomik për zgjatje të afatit për dorëzim respektivisht hapje të ofertave

III. Data: 06.01.2025

IV. Lënda e kontratës:

Titulli i kontratës: “Shërbime IT Pen-Test dhe Vlerësimi i Sigurisë së Sistemit SWIFT” 2 (pjesë/lote)

Vlera e parashikuar e kontratës:

LOT 1: 60,000.00 Euro/2 vite

LOT 2: 20,000.00 Euro/2 vite

V. Numërtimi i prokurimit: BQK 24 039.1 221

VI. Zgjatja e afatit për dorëzim dhe hapje të ofertave:

Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata të tjera:

VI.1. Afati i fundit pas zgjatjes për sqarime dhe tërheqje të dosjes së tenderit: 16.01.2025 ora 14:00 në e-mail adresën: prokurimi@bqk-kos.org.

VI.2. Afati i fundit pas zgjatjes për dorëzim të ofertave: **20.01.2025, ora 14:00.**

IV.3. Takimi për hapjen e ofertave pas zgjatjes: **20.01.2025, ora 14:30.** Vendi: Objekti i BQK-së, Rr. “Garibaldi” nr. 33.

VII. Arsyeja e zgjatjes së afatit:

Zgjatja e afateve kohore për tërheqjen e dosjes së tenderit, dorëzimit dhe hapjes së ofertave ndërlidhet me kërkesat e paraqitura nga operatorët ekonomik për zgjatje dhe sqarime shtesë. Si rrjedhojë, sipas nenit 25, paragrafit 7 të Rregullës për Prokurimit Banka Qendrore bënë zgjatjen e afateve kohore për t'ju ofruar operatorëve ekonomik kohë të mjaftueshme për përgatitjen e tenderëve dhe dorëzimin e ofertave të tyre, gjithmonë duke i zbatuar parimet e përgjithshme të prokurimit, publicitetin, transparencën, mos-diskriminimin, trajtimin e barabartë dhe konkurrencën e drejtë.

VIII. Ankesat

Në përputhje me nenin 48 të Rregullës për Prokurimin në BQK, palët e interesuara mund të parashtrojnë ankesë brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t'u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

IX. Adresa

Rr. "Garibaldi" 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): www.bqk-kos.org	
Personi kontaktues: Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimit	E-maili: prokurimi@bqk-kos.org
Telefoni:	038 222 055/451